



**KUVENDI I KOMUNËS–SUHAREKË
SKUPŠTINA OPSTINE - SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA**



KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI – SUHAREKË

Nr. Protokollit	03/ 2024
Vendi i takimit:	Salla e Bordit të Drejtorëve
Datë:	18.06.2024

PROCESVERBAL

Nga takimi i Këshillit Komunal për Sigurinë e Bashkësive “KKSB” - Suharekë të paraparë sipas Udhëzimit Administrativ të nënshkruar nga Ministria e Punëve të Brendshme, Nr-27/2012, dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Nr-03/2012, për themelimin e Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi (KKSB).

Takimi filloi në ora 10.00

Në takim morën pjesë :

Afrim Sylaj - Komandant në Stacionin Policor në Therandë
Halim Shehu - përfaqësues i Komunitetit Islam
Albert Demaj - përfaqësues i Komunitetit Katolik
Enver Shabani - Drejtorja e shërbimeve publike, siguri dhe emergjencë
Fetije Bytyqi - përfaqësuese e EVSB-së
Remzi Bajselmani - Drejtor i Drejtorisë së arsimit
Habibe Bytyqi - Zyrtare për barazi gjinore
Albestrim Rexhepi - përfaqësues i FSK-së
Drilon Zyba - përfaqësues i KLSP-së
Adem Derguti - Kryetar i KPAK-së
Rozeta Jahaj - përfaqësuese e OJQ-të
Refki Zogaj - përfaqësues i komunitetit të biznesit
Eurolinda Zenelaj - përfaqësuese e mediave lokale
Xheladin Sadikaj - përfaqësues i zyrës KKK-së
Qëndresa Baftjaraj - përfaqësuese e KPAK-së
Myrvete Shala - përfaqësuese e Shqiptarëve
Denis Sofra - Kryesues i KK-së dhe përfaqësues i KA-li
Zekë Berisha - përfaqësues i Romëve
Nazim Shabanaj - përfaqësues i Egjiptasve

Mbledhjen e hapi Nënkyetarja e Komunës znj. Mihrije Suka e cila i njoftoi me rendin e ditës.

Rend dite

- 1. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Diskutim për aktivitetet organizuara nga Drejtoria e Arsimit për maturantët;**
- 3. Prishja e rendit dhe qetësisë publike nga lokalet e natës dhe personat e pa përgjegjshëm;**
- 4. Parapërgatitja dhe vetëdijesimi i qytetarëve për mbrojtje nga zjarri gjatë sezonit veror ;**
- 5. Identifikimi i hapësirave publike ku cenohet lëvizja e lirë e qytetarëve;**

Nënkyetarja - e hedh në votim rendin e ditës.

Aprovohet rendi i ditës

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Nënkyetarja - e hedh në votim pikën 1.

Aprovohet Pika 1

Pika 2. Diskutim për aktivitetet organizuara nga Drejtoria e Arsimit për maturantët;

Remzi Bajselmani - përshëndet të pranishmit. Sa i përket aktiviteteve që janë organizu për maturantët e Komunës së Suharekës, çdo gjë ka shku në rregull. Këtë vit testi i maturës ka qenë online i cili ka paraqit disa vështirësi dhe 97% e maturantëve e kanë paraqit me sukses provimin dhe ne si drejtori e Arsimit po merremi që edhe këta nxënës që kanë mbet me përfunduar këtë procedurë. Ekskurzionet kanë përfundmu sipas planifikimit dhe pa vërejtje. Gjithë ashtu shkollat kanë organizua mbrëmjet e maturës dhe mbrëmjet kanë shku sipas rregullave dhe pa asnjë incident. Janë rreth 600 maturantë që pritet me 22.06.2024 t'i nënshtrohen testit të maturës dhe shpresoj që do të kemi sukses.

Avni Bytyqi - edhe vitin e kaluar ka qenë situatë e njëjtë dhe është përgëzë DKA për organizimet e tilla dhe besoj edhe këtë vit e meriton të përgëzohet për organizime të tilla.

Rekomandim: Le të vazhdojë Drejtoria e Arsimit me organizime të tilla pa hezitime për arsye se edhe KKSB-ja dhe komuna besoj që e përkrahin.

Nënkyetarja - e hedh në votim rekomandimin.

Aprovohet rekomandimi

Pika 3. Prishja e rendit dhe qetësisë publike nga lokalet e natës dhe personat e pa përgjegjshëm;

Nënkyetarja - siç e dini shumë e rëndësishme është qetësia si dhe siguria e qytetarëve të Komunës andaj ne si komunë vazhdimisht kemi marrë masa që ta kemi një qetësi dhe siguri publike. Drejtoria e Inspeksionit vazhdimisht bën kontrolla nëpër lokale në bashkëpunim me policinë dhe deri më tani nuk kemi pas ndonjë problematikë të madhe.

Bashkim Gashi - përshëndet të pranishmit. Rendi dhe qetësia publike është çështje elementare e domosdoshme. Policia në këtë drejtim e jep kontributin e vet duke u bazu në ligjin për rendin dhe qetësinë publike. Jam në kontakte të shpeshta me Drejtoreshën e Inspeksionit dhe e kam pas përkrahjen e saj. Pasi jemi fut në sezonin veror ,ne kemi planifiku aktivitetet tona të përbashkëta me partenët tonë të besueshëm relevant duke fillu nga qeveria dhe të gjitha organizatat jo qeveritare të cilat ia duan të mirën vendit dhe këtu e kemi parapa pikërisht prishjen e rendit dhe qetësisë publike.

Avni Bytyqi - jep sqarime sa i përket futjes së kësaj pike në rend dite dhe del me rekomandim.

Rekomandim: ku do që hasin qytetarët që ka lokale të natës që prishin rendin dhe qetësinë publike dhe ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të kundërligjshme,të raportojnë në polici dhe në Inspektoriat.

Nënkryetarja - e hedhë në votim rekomandimin.

Aprovohet rekomandimi

Pika 4. Parapërgatitja dhe vetëdijesimi i qytetarëve për mbrojtje nga zjarri gjatë sezonit veror ;

Nënkryetarja - rreziku ndaj zjarreve gjithherë ekziston mirëpo rreziku më i madh është gjatë sezonit të verës. Komuna ka një plan të veprimit dhe për këtë çështje ia jap fjalën Drejtorit të Shërbimeve Publike.

Enver Shabani - DSHPE pothuaj vite me radhë e kemi shëndrru në tradicionale që ta bëjmë një njoftim publik me fillimin e sezonit veror ose me ngritjen e temperaturave verore.

Jemi në prag të fushatës së korrjeshirjeve që gjithashtu do të jemi vigjilent ne si drejtori bashkë me shërbimet zjarrëfikëse që fatkeqësisht numri është i vogël por ne do të bëjmë përpjekje që të bëjmë disa njesi vullnetare së paku nëse mund të organizohemi nëpër fshatra. Ne zakonisht e bëjmë një thirrje publike nëpërmjet zyrës së Kryetarit, thirrje për apel për shtuarje të kujdesit dhe vigjilencës që të gjithë të jenë të gatshëm në parandalimin e zjarrit. Këto njoftime i bëjmë edhe përmes Radio Valës. Do të bëjmë dhe një kërkesë shtesë në ministri për rritjen e numrit të zjarrëfikësave nëse ata pranojnë.

Refki Zogaj - E dime që tani janë korrjeshirjet dhe kisha apelua te Drejtoria e Bujqësisë që vepron në kuadër të komunës që çdo kompanie i cili është në teren, çdo kompani duhet ta ketë një traktor të vetin me pllugj për arsye se në çoftëse vjen deri te një shkëndijë e një zjarri mund ta lokalizojë mu në atë parcellë.. Apeloj nënkryetare që ti drejtoheni Drejtorisë së inspektorëve, të dalin në teren dhe në ato vende ku e shofin rrezikshmërinë dhe mosmirëmbajtjen rreth e për qarkë kompanisë së tyre, ti jepet vërejtje që ta bën pastrimin rreth kompanisë nga barojat e këqija dhe nëse nuk i implementon të pason dhe denimi në mënyrë që mos të pësojmë ne bizneset e ndërgjegjshme nga ato biznese që janë të pandërgjegjshme.

Nënkryetarja - komuna do të bëjë një njoftim që secili biznes pjesën e vet para biznesit të tij ta mirëmbaj. Edhe më herët ka qenë një njoftim i tillë dhe komuna ka për obligim ta ripërsëris këtë njoftim.

Enver Shabani - Kryetari i bizneseve ka shumë të drejtë sepse nga përvojat e kaluara kemi pas probleme në Zonën Industriale e në disa fshatra sepse me ngritjen e temperaturave rritet edhe numri i zjarreve dhe kapaciteti i zjarrëfikësave është i vogël. Drejtori tutje i njofton të pranishmit sa i përket kësaj pike.

Refki Zogaj - i keni në dispozicion 600.000 l ujë sepse unë bazenin e kam vetëm për raste emergjente.

Enver Shabani - faleminderit kryetar por nuk e kemi problemin vetëm me ujë por njerëz nuk kemi. Paisje kemi dhe neve na lejon ligji me marrë edhe në pishina ujë. Andaj të gjithë duhet të kujdesemi në parandalimin e zjarreve.

Rekomandim 1: Të ngritet vigjilenca në Drejtorinë e Shërbimeve Publike gjatë sezonës së verës dhe të ketë takime me kryetarët e fshatrave me qëllim që të organizojnë zjarrëfikës vullnetarë në komunën tonë.

Rekomandim 2: Të del Drejtoria e Shërbimeve Publike me apelin për ngritjen e vigjilencës dhe njoftimin e qytetarëve për rrezikun e ambullive që tash ndodhin korrje-shirjet dhe që mos ti ndezin.

Rekomandim 3: Të njoftohen pishinat që në raste emergjente ti ndihmojnë zjarrfikësive që të furnizohen me ujë nga pishinat e tyre.

Avni Bytyqi - vitin e kaluar nëse nuk gaboj është organizuar një trajnim në Vushtrri. Ndoshta do të ishte mirë me pas një takim të shpejt me kryetar të fshatrave dhe me i përzgjedh disa persona dhe me organizu një trajnim në Vushtrri ku do të specializohen rreth çështjes së fikjes së zjarreve dhe në momentin që këta qertifikohen, ne me fillu me procedurat e marrjes së vendimit në Asamble për ti liruar nga shërbimet e QKMF-së si një lloj stimulimi.

Enver Shabani - është e vërtetë që vitin e kaluar kemi bë një trajnim në Vushtrri ku 12 persona janë qertifiku. Nuk e di a ka trajnime të tilla por jemi të detyruar me organizu një trajnim të tillë.

Rekomandim 4: Të organizohet një trajnim për vullnetarët që paraqiten për fikjen e zjarreve për Komunën e Suharekës.

Nënkryetarja - i hedh në votim rekomandimet.

Aprovohen rekomandimet

Pika 5. Identifikimi i hapësirave publike ku cenohet lëvizja e lirë e qytetarëve;

Nënkryetarja - një prej elementeve kryesore është edhe lëvizja e lire e qytetarëve andaj ne si komunë vazhdimisht kemi bë punë siq është shtrimi i trotuareve, lirimi i hapësirave.

Avni Bytyqi - kjo pikë ka të bëj më tepër me lokalet të cilat i zënë hapësirat publike para lokaleve dhe nëse keni informacione, ju lus që ta njoftoni policinë dhe Drejtorinë e Inspeksionit.

Bashkim Gashi - përgjatë rrugës "Brigada 123" kemi mjaft aktivitete ekonomike dhe operatorët ekonomikë që bëjnë transportimin e mallrave e kanë të pamundur realizimin e kësaj të drejte. Unë mendoj që të rezervohen disa hapësira publike nëpër trotuare ku është gjerësia më e madhe dhe ku mund të parkohen kamionetat dhe në një kohë solide ta bëjnë zbrazjen e mallrave.

Habibe Bytyqi - dy projektet që përmende nënkryetare e që realisht njerit prej tyre unë i takoj asaj zone, vazhdimisht kam pyetje prej qytetarëve se deri kur është plani dinamik për rrugën "Skënderbeu". Kur pritet të përfundoj ajo rrugë?

Enver Shabani - secili qytetar ka të drejtë me qenë i nformuar. Planin dinamik nuk mund ta them përmendësh por e di që është planifiku të përfundoj para sezonit të mërgimtarëve, rreth 1 gushtit por kjo nuk do të ndodh. Deri me 1 gusht do të lëshohen dy traka për lëvizje dhe qarkullim sepse nuk mund të ndodh të përmbyllet 100% projekti por ka me qenë e kalueshme.

Rekomandim: Të njoftohen policia dhe inspeksioni që të dalin në teren për identifikimin dhe lirimin e hapësirave publike ku cenohet lëvizja e lire e qytetarëve.

Nënkryetarja - e hedh në votim rekomandimin.

Aprovohet rekomandimi

Takimi përfundoi: 10:50

Procesmbajtësja:
Dafina Haziraj